



Keep
EVOLVING

Përmbajtja

Pse të zgjidhni Englanders	02
Grupe dhe konsorciume universitare britanike	05
Programe përgatitore universitare (Pathway providers)	05
Nivele akademike në Mbretërinë e Bashkuar	06
Rankimet më të rëndësishme në botë	07
Rankimet më të rëndësishme në Britani	07
CAS dhe Integrated CAS	08
Testet e pranimit në UK	08
1.The University of the West of Scotland	09
2.City, University of London	11
3.London South Bank University (LSBU)	13
4.Queen Mary (University of London)	15
5.University of Portsmouth (UoP)	17
6.Cambridge School of Visual & Performing Arts (CSVPA)	19
7.BPP University, London	21
8.University of East London (UEL)	23
9.Brunel University (University of London)	25
10.Coventry University	27
11.University of Manchester	29
12.University of Westminster	31
13.Greenwich University	33
14.Queen's University Belfast	35
15.University of Reading	37
16.City St George's (University of London)	39
17. University of Sunderland (Londër dhe Sunderland)	41
Rreth Englanders	42



Contact us



Apply online

Pse të zgjidhni ENGLANDERS

Qasja jonë është 360°

Në Englanders, çdo student trajtohet si një projekt unik. Ne nuk ofrojmë thjesht opsione – ne ndërtojmë rrugën tuaj drejt universitetit dhe karrierës së duhur.

Procesi i vendimmarrjes është kompleks dhe përfshin shumë faktorë: profilin akademik, nivelin e gjuhës, zgjedhjen e vendit dhe universitetit, mundësitë financiare dhe objektivat afatgjata. Roli ynë është të strukturojmë këtë proces dhe t'ju udhëheqim me siguri në çdo hap.



Prezantimi i ofertave:

Ne përzgjedhim dhe ju prezantojmë vetëm opsionet më të përshtatshme, të bazuara në profilin dhe potencialin tuaj.



Këshillim për pranimin e ofertës:

Ju ndihmojmë të merrni vendimin e duhur, duke balancuar cilësinë akademike, koston dhe perspektivën e karrierës.



Negocimi i bursave:

Punojmë për të siguruar maksimumin e mundshëm të bursave dhe përfitimeve financiare për ju.



Mbështetje e plotë në dokumentacion:

Sigurojmë përgatitje dhe verifikim të saktë të çdo dokumenti për një aplikim të fortë dhe pa gabime.



Këshillim i personalizuar:

Çdo student merr mbështetje individuale, të ndërtuar mbi objektivat dhe ambiciet e tij.



Aplikimi për vizë:

Ju udhëheqim në çdo fazë të procesit të vizës studentore, me fokus në saktësi, përpunshmëri dhe sukses.

Grupe dhe konsorciume universitare britanike

University of London

University of London është një sistem federal ku programet dhe diplomat rregullohen nga një kornizë qendrore, duke garantuar standarde të njëjta akademike. Një institucion pjesë e 'University of London' dallohet sepse diploma ka peshë të fortë ndërkombëtare dhe rregulla të qarta akademike.

Russell Group

Një universitet që është pjesë e këtij grupi konsiderohet një garanci cilësie, duke qenë akademikisht i fortë dhe i besueshëm në MB. Ato njihen për nivelin e lartë të kërkimit shkencor, reputacionin e shkëlqyer dhe standardet e larta të pranimet. Gjithashtu, diplomës i jepet një vlerë e veçantë nga punëdhënësit, ndërsa mësimdhënia realizohet nga profesorë të angazhuar aktivisht në kërkim shkencor.

NCUK (Northern Consortium UK)

NCUK ofron International Foundation Year (IFY) dhe International Year One (IY1) si rrugë të strukturuar për studentët ndërkombëtarë drejt universiteteve partnere në MB. Progresi nuk është automatik për çdo universitet, por është i garantuar nëse plotësohen kriteret akademike dhe të gjuhës.

Programe përgatitore universitare (Pathway providers)

NCUK – konsorcium me study centres të pavarura dhe zgjedhje më të gjerë universitetesh partnere.

Navitas, Kaplan & Cambridge Education Group (OnCampus) – operatorë privatë me kolegje të lidhura drejtpërdrejt me një universitet të caktuar.

Nivele akademike në Mbretërinë e Bashkuar:

Foundation – program përgatitor njëvjeçar që ndihmon studentët të arrijnë nivelin akademik dhe gjuhësor për fillimin e studimeve universitare. Bëhet pas maturës Shqiptare dhe mund të zhvillohet në kolegji/ boarding school ose Universitet.

Kujdes: Matura në Britani përfundon pas 13 vite shkollë.

IY1 (International Year One) – ekuivalent me vitin e parë të bachelor-it, që lejon kalim direkt në vitin e dytë të universitetit. I vlefshëm vetëm për disa degë dhe i limituar vetëm në disa universitete; kërkon mesatare shumë të fortë dhe nivel Anglishteje të lartë.

Undergraduate (BA/BSc/ BEng,) – program universitar bazë që çon në diplomë bachelor dhe zgjat zakonisht 3 vite në Britani dhe 4 vite në Amerikën e Veriut (Amerikë dhe Kanada).

Pre-Master (Foundation Master) – program përgatitor për studentë që nuk plotësojnë ende kushtet për hyrje direkte në master. Mund të zgjasë nga 1 deri në 2.5 semestra. I limituar vetëm në disa Universitete.

Postgraduate (Master) – program i avancuar pas bachelor-it, i fokusuar në specializim akademik ose profesional. Zakonisht 1 vit në Britani dhe 2 vite në Amerikën e Veriut (Amerikë dhe Kanada)

Pre-sessional English – kurs intensiv i anglishtes akademike për studentë që kanë pranim të kushtëzuar në universitet. Zgjat nga 5 javë deri në 2 semestra. I limituar vetëm në disa universitete, me mundësi për studime online (pa të drejtë vize ose në kampus (me të drejtë vize).

Rankimet më të rëndësishme në botë

QS World University Rankings – fokusohet tek reputacioni akademik, punësimi i të diplomuarve dhe internacionalizimi. Është shumë i përdorur nga studentët ndërkombëtarë.

Times Higher Education (THE) – vlerëson cilësinë e mësimdhënies, kërkimin dhe ndikimin shkencor. Konsiderohet më akademik dhe metodologjikisht rigoroz.

Rankimet më të rëndësishme në Britani

Complete University Guide – kombinon cilësinë akademike, kënaqësinë e studentëve dhe punësimin pas diplomimit. Është referenca më e balancuar në MB.

The Guardian University Guide – fokusohet te përvoja reale e studentit dhe mësimdhënia. Shpesh nxjerr rezultate ndryshe nga rankimet tradicionale.

Times and Sunday Times Good University Guide – përqendrohet në reputacion, burime akademike dhe performancë. Përdoret gjerësisht në MB për zgjedhje universitare.

Scottish University Guide është një renditje rajonale që krahason universitetet në Skoci duke u fokusuar te cilësia e mësimdhënies, kënaqësia e studentëve dhe rezultatet në punësim.

Kujdes: Renditja Universitare varet gjerësisht nga fokusi i Universitetit psh: praktika kundrejt kërkimit edhe nga jetëgjatësia; psh: Young University Guide përmban universitetet me jetëgjatësi deri 50 vjet.

CAS dhe Integrated CAS

(Confirmation of Acceptance for Studies) është dokumenti zyrtar ose letra e pranimit që universiteti lëshon pasi studenti plotëson kushtet e ofertës së kushtëzuar; CAS përdoret për aplikimin për vizë studentore në MB.

Shembull: pranim direkt në Bachelor ose Master.

Integrated CAS përdoret kur studenti fillon me program përgatitor dhe vijon më pas me programin kryesor; ICAS mbulon të gjithë itinerarin pra lëshohet në mënyrë të integruar nga i njëjti universitet.

Shembull: Foundation + Bachelor ose Pre-Master + Master në një universitet/partner të vetëm.

Programet që japin të drejtën e **Graduate Route Visa**
- 2 vite vizë e hapur pune pas studimeve:

- Bachelor/ Undergraduate
- Master/ Postgraduate
- **Graduate Route Visa** nuk ka kërkesa financiare.
- Mund të aplikohet nga brenda Mbretërisë së Bashkuar, pa u kthyer në Shqipëri.
- Kohëzgjatja aktuale është 24 muaj, me ndryshime të pritshme nga Janari 2027, bëhet 18 muaj.
- Lejon qëndrimin dhe punësimin në Mbretërinë e Bashkuar pas përfundimit të studimeve.

Testet e pranimit në UK

Disa universitete, veçanërisht ato më konkurruese, kërkojnë këto teste si pjesë e aplikimit Bachelor. Testet zhvillohen zakonisht nga Gusht–Tetor dhe kanë kapacitet të kufizuar.

- **Drejtësi** → LNAT
- **Mjekësi / Stomatologji** →UCAT (BMAT përdoret më parë, por po hiqet gradualisht)
- **Matematikë / Ekonomi** (universitete elitare) → TMUA, MAT ose STEP
- Shumica e programeve të tjera - nuk kërkohet test (përveç IELTS UKVI)

Këshillë: Regjistrimi i hershëm është thelbësor — na pyesni, rezervoni testin dhe planifikoni aplikimin në kohë për të rritur shanset e pranimit.

1. The University of the West of Scotland

Ndryshe nga universitetet tradicionale të orientuara drejt kërkimit, UWS priorizon përgatitjen për tregun e punës — duke ofruar një rrugë më direkte drejt karrierës. UWS ka rreth 140 vjetecare dhe është një universitet modern britanik i fokusuar në aftësi praktike dhe punësim real.

Kampusi i Londrës, në London Docklands pranë Canary Wharf, i vendos studentët në një nga qendrat më të fuqishme ekonomike në botë. Afërsia me Westfield Stratford City — një nga qendrat tregtare më të mëdha në Europë — ka mundësi reale për punësim gjatë studimeve.

Në të njëjtën kohë, UWS ka 4 kampuse te tjera në Skoci (Paisley, Lanarkshire, Ayr dhe Dumfries), duke ofruar një alternativë me kosto më të ulët jetese dhe kërkesa më të reduktuara për maintenance funds në UKVI, ideale për studentët që kërkojnë një opsion më ekonomik.

Si agjenci, Englanders renditet si partneri kryesor në treg për dërgimin e studentëve drejt UWS.

- **91% e të diplomuarve janë në punë** ose në studime të mëtejshme — një tregues i drejtpërdrejtë i fokusit në punësueshmëri.
- Lokacion strategjik në **London Docklands**, disa minuta nga East India DLR dhe pranë Canary Wharf — epiqendra e financës dhe biznesit global.
- Komunitet ndërkombëtar me 130+ kombësi, duke krijuar një ambient të pasur kulturor dhe profesional.
- Ambiente moderne studimi, përfshirë një atrium të hapur dhe hapësira bashkëpunimi me standarde të larta urbane.
- 3 mundësi nisjeje studimesh (**Shtator, Janar, Maj**) — fleksibilitet maksimal për studentët ndërkombëtarë
- **Conversion degrees në IT dhe Project Management** — mundësi për të ndryshuar drejtimin e karrierës pa qenë i kufizuar nga diploma Bachelor.
- **Foundation Year** — një rrugë e sigurt hyrjeje ne systemin akademik Britanik për studentët që kanë nevojë për përgatitje akademike shtesë.
- Hapësira sociale dhe networking të hapura edhe për studentë nga universitete të tjera, duke zgjeruar ndjeshëm rrjetin profesional.
- Track record of compliance UKVI - reflekton besueshmëri, standarde të larta dhe besueshmëri nga autoritetet emigratore.
- **Bursa deri në £7,000**, ndër më konkurrueset në këtë kategori universitetesh.
- Mundësi zgjedhjeje midis **Londrës** (karrierë + mundësi pune) dhe **Skocisë** (kosto më e ulët + kërkesa më të lehta financiare).

Përshëndetje. Unë jam **Xhesika Bicaku** dhe kam përfunduar studimet në University of the West of Scotland në programin **MSc Information Technology**.

Mundësia për të studiuar në një universitet në UK ishte hapi i parë që më ndihmoi të siguroj një Skilled Worker visa fill pas studimeve dhe prej një viti **tanimë punoj si Software Developer** për një kompani softuerike në Londër.

UWS UNIVERSITY OF THE
WEST of SCOTLAND

Fakultetet / Departamentet

- Biznes dhe Industri Kreative
- Teknologji, Inxhinieri dhe Shkenca Fizike
- Edukim dhe Shkenca Shoqërore
- Shëndet dhe Shkenca të Jetës
- Drejtësi dhe Shkenca Shoqërore

Arritjet

- Scotland's University of the Year për përfshirje sociale 2026 (The Times Good University Guide)
- Më shumë se 9 nga 10 të diplomuar janë në punë ose studime të mëtejshme pas diplomimit.

Kampuset

- Kampusi Londër: London Docklands, pranë Canary Wharf.
- Kampuset kryesore në Skoci: **Paisley, Hamilton, Ayr, Dumfries**



2.City, University of London

City, University of London, i themeluar në 1894, është pjesë e University of London dhe ndodhet në zemër të Londrës. Me mbi 27,000 studentë nga 170+ vende në tre kampuse, universiteti është lider në shëndetësi dhe mjekësi, si dhe në biznes, drejtësi, komunikim dhe teknologji, duke kombinuar ekspertizë ndërdisiplinore për ndikim real shoqëror.

- Programet foundation, undergraduate dhe postgraduate integrojnë employability modules, përfshirë English for Academic Purposes me fokus profesional.
- Partneritet me Virtual Internships, që ofron përvojë pune online me 3,500+ kompani në 70 vende, gjatë studimeve.
- Vendndodhja pranë financial district të Londrës ofron akses të drejtpërdrejtë te punëdhënës dhe mundësi praktike.
- 20,000 studentë me një rrjet prej 175,000 alumni në mbarë botën.
- Programe në biznes, drejtësi, komunikim, politikë, shkencë dhe teknologji
- Më shumë se dy të tretat e programeve të saj njihen nga organe profesionale (si BCS, BPS dhe RICS), duke siguruar që kurrikula të jetë e përshtatshme për industrinë.
- Programe bachelor me foundation year të integruar (ICAS), veçanërisht në inxhinieri dhe fusha teknike.
- Biznesi Bayes (ish Cass) është një nga 1% e shkollave të biznesit në botë me akreditim të trefishtë nga AACSB, AMBA dhe EQUIS, duke e vendosur ndër elitën globale të arsimit të biznesit.
- Tre kampuse moderne në Clerkenwell, Moorgate dhe Tooting, me facilities bashkëkohore dhe akses të plotë në jetën profesionale të qytetit.

“ Një feedback nga zemra për këdo që dëshiron të studiojë në Angli, ashtu siç bëra edhe unë. Englanders CR janë the bestt! Një falënderim i veçantë për Znj. Valbona, e cila më ka mbështetur në çdo hap – nga aplikimi për Foundation, te viza për Bachelor, e deri te viza për Master dhe Bar Course. Ti ishe zgjedhja e duhur prandaj të ri-zgjodha dhe do të zgjedh gjithmonë pa hezitim! Pas gati 8 vitesh në Londër, e diplomuar në drejtës dhe duke ushtruar profesionin tim, mund të them me bindje se ju e bëtë ëndrrën time realitet.

Faleminderit pafund për profesionalizmin, përkushtimin dhe mbështetjen tuaj!

Jua rekomandoj të gjithëve t'ia besoni shërbimin e vizave angleze Englanders CR.

Serie Dyrma

Program - Bar Vocational Studies / LLM





**CITY UNIVERSITY
LONDON**

Fakultetet / Departamentet

- Bayes School of Business
- Drejtësi
- Matematikë, Shkenca Kompjuterike dhe Inxhinieri
- Arte dhe Shkenca Sociale
- Shkencat Psikologjike

Arritjet

- Të diplomuarit në gazetari punojnë në media si BBC, Reuters, Financial Times dhe The Guardian.
- 86% e kërkimeve të City-t janë vlerësuar si me cilësi botërore (4)* ose shumë të mira ndërkombëtarisht (3)* (REF 2021)
- Renditur i 7-ti në Mbretërinë e Bashkuar për përqindjen e të diplomuarve që hyjnë në role me kualifikime të larta.
- ndërkombëtare të arsimit të lartë.

Kampuset

- Main Campus – Northampton Square, zona Finsbury, Islington
- City Law School – Sebastian Street, Islington
- Bayes Business School – St Luke's, Islington dhe 200 Aldersgate, Smithfield, City of London
- St George's Hospital Medical School – St George's Hospital, Tooting
- City St George's International Study Centre – Spitalfields, Tower Hamlets



3. London South Bank University (LSBU)

Universitet publik dinamik në zemër të Londrës, i njohur për qasjen praktike dhe orientimin e fortë drejt karrierës. Me një komunitet të madh dhe ndërkombëtar studentësh, programe përgatitore dhe studime të ndërtuara me industrinë, LSBU ofron një fillim të sigurt për ata që synojnë sukses akademik dhe profesional në Mbretërinë e Bashkuar.

- Partneritete me industri: Bashkëpunim me mbi 2,000 kompani, përfshirë Unilever, Network Rail dhe London Underground.
- LSBU ofron Foundation Year, International Year 1 dhe Pre-Master, disa kurse përfshijnë vit pune (sandwich year) dhe top-up degrees për të përfunduar vitin e fundit në MB dhe marrë një diplomë britanike.
- £38,300 janë fitimet e shumë të punësuarve vitin e parë pas studimeve.
- Kampusi kryesor në Elephant and Castle, me investime mbi £65 milion dhe ambiente të avancuara studimi.
- Mbi 150 kurse për studentë bachelor dhe master, kurse parapërgatitore, me mundësi për placement ose top-up degrees.
- Studentë nga mbi 130 vende, duke krijuar një mjedis multikulturor
- Shërbime akademike, karriere dhe zhvillim personal.
- I përfshirë në shëndetësi, biznes, inxhinieri dhe sektorë kreativë

“Përshëndetje. Universiteti plotësoi të gjitha pritshmeritë e mia duke ofruar kushte bashkëkohore dhe staf shumë mikpritës dhe profesionist. Konsulenca e Englanders Cr më ndoqi në çdo hap të këtij rrugëtimi duke e bërë çdo gjë me të lehtë për mua.

Merkan Cekaj

Program - BSc Psikologji në London South Bank University





EST 1892

LSBU

London South
Bank University

Fakultetet / Departamentet

- Shkenca të Aplikuara
- Arte dhe Industri Kreative
- Mjedis i Ndërtuar dhe Arkitekturë
- Biznes
- Inxhinieri
- Shëndet dhe Kujdes Social
- Drejtësi dhe Shkenca Shoqëror

Arritjet

- Renditet i 17- i në Mbretërinë e Bashkuar për pagat hyrëse të të diplomuarve
- Renditet i 77- i në Guardian University Guide 2026
- Universiteti i Vitit 2025 për Përfshirje Sociale sipas Daily Mail

Kampuset

- **Kampusi kryesor:** Southwark, pranë Elephant and Castle, i kufizuar nga Borough Road, London Road dhe Southwark Bridge Road.
- **Zona përreth:** St George's Circus, Waterloo dhe London Bridge.
- **Kampusi satelit:** Havering, përballë stacionit Harold Wood.
- **Kampusi në Croydon:** Electric House, Wellesley Road (i hapur në shtator 2021).



Scan here for
a virtual tour



4. Queen Mary (University of London)

Me një histori që nis në vitin 1785 dhe mbi 170 kombësi studentësh në kampuset e tij në Londër, Queen Mary University of London ka prani akademike edhe në Kinë, Maltë dhe Paris, duke ofruar një eksperiencë ndërkombëtare unike studimi. Si i vetmi universitet i Russell Group në Londër me kampus të përqendruar, Queen Mary kombinon jetesën e sigurtë studentore me energjinë e një prej qyteteve më dinamike në botë.

- Programe undergraduate dhe postgraduate me mundësi viti exchange në **Mjekësi, Drejtësi, Shkenca Kompjuterike, IT, Biznes dhe Inxhinieri**.
- **9 nga 10 të diplomuar punësohen** ose vazhdojnë studimet brenda 15 muajve; bashkëpunime me Google, IBM, PwC, KPMG etj.
- Programet master lidhen ngushtë me kërkimin shkencor dhe projekte inovative.
- Infrastrukturë moderne: laboratorë të avancuar, bibliotekë 24/7, ambiente sportive dhe hapësira sociale.
- **Bursa deri në £12,000** për undergraduate dhe mbështetje financiare për postgraduate dhe studentë ndërkombëtarë. <https://www.qmul.ac.uk/international-students/tuitionfees/feesfinance/>
- Mbështetje individuale për karrierën përmes mentoring-ut, workshop-eve dhe eventeve për krijimin i networkut. Përmes agjencisë së rekrutimit të Universitetit, QTemps, studentët mund të gjejnë vende pune në kampus ose në afërsi të tij gjatë ose pas diplomimit.
- Qendra e Këshillave Ligjore Queen Mary, është vlerësuar me çmime. E themeluar në vitin 2006, qendra ka në staf studentësh vullnetar të drejtësisë të cilët ofrojnë këshilla falas dhe të arritshme për publikun e gjerë mbi një sërë çështjesh ligjore.
- Mbi 31,000 studentë, 43% ndërkombëtarë në programet e diplomës, dhe mbi 5,700 anëtarë stafi

Udhëtimi im akademik në UK filloi falë mbështetjes së Englanders, të cilët më ndihmuan të fitoj bursën ESBA për shkollat e mesme. Pas përfundimit me sukses të 2 viteve A-Level, pata mundësinë të vazhdoj studimet në një nga universitetet më të mira për degën që dëshiroja. Në **Queen Mary University of London në degën Bachelor of Arts**.

Jam shumë mirënjohëse për gjithë mbështetjen dhe guidën që mora gjatë këtij rrugëtimi. Faleminderit Englanders që ma bëtë të mundur këtë ëndërr!

Samantha Mustafaj

Program - BA Arts - Fituese e Bursës ESBA nga Englanders

Fakultetet / Departamentet

- Shkencat Humane dhe Shoqërore
- Shkencat dhe Inxhinieria
- Mjekësi dhe Stomatologji
- Drejtësi (përfshirë Qendrën e Ligjit Komercial)
- Biznes dhe Menaxhim
- Shkencat Biologjike dhe Kimike

Arritjet

- **9 fitues të Çmimit Nobel** për kontribute në shkencë dhe mjekësi.
- I renditur i 7-ti në Mbretërinë e Bashkuar për cilësinë e kërkimit shkencor.

Kampuset

- **Kampusi kryesor:** Mile End
- **West Smithfield:** Klinikë dhe kërkim
- **Lincoln's Inn Fields:** Drejtësi
- **Charterhouse Square:** Institut Kërkimor



5. University of Portsmouth (UoP)

University of Portsmouth është një universitet publik modern që daton nga 1870. Ai njihet për mësim praktik dhe punësim të lartë pas diplomimit. Ofron programe në biznes, teknologji, shkencë dhe fusha kreative, me sistem studimi të veçantë - kurse që zhvillohen një nga një/ Block teaching - për fokus maksimal.

Portsmouth është qytet studentor në Jug të Britanisë, ndërsa kampusi i Londrës, pranë Walthamstow Central, i lidh studentët lehtësisht me metropolin Londinez dhe mundësitë e shumta profesionale.

- Universiteti ofron placement, projekte industriale dhe mundësi internship me kompani si IBM, Deloitte dhe L'Oreal.
- I mirënjohur për programet në Biznes, Inxhinieri, Shkenca Kompjuterike, Shëndetësi, Media dhe Teknologji.
- Studimet Master janë të mirënjohura në arenën ndërkombëtare për Kozmologjinë, Astrofizikën, Cyber Security dhe Forensics.
- Investime masive: 250 milion £ në masterplanin që përfshin godina të reja si dhe rehabilitimin e ndërtesave ekzistuese.
- Mbi 29,000 studentë, 150+ vende, ofron mjedis multikulturor global.
- Laboratorë modernë, bibliotekë 24/7, qendra sportive dhe ambiente sociale, duke përmirësuar përvojën akademike dhe sociale.
- Mbi 150 klube dhe shoqëri, evente networku dhe mundësi zhvillimi personal.
- Qyteti i Portsmouth ofron kosto të arsyeshme jetese dhe lidhje të mira transporti drejt Londrës dhe qyteteve të tjera si Southampton - vetëm 1 orë larg.
- Bursa dhe mbështetja financiare përfshijnë ulje tarifash deri £5,000 për studentët ndërkombëtarë, bursa sportive dhe mbështetje për Master.

Unë jam **Xhafer Lile** dhe mbarova studimet për **Tourism & Hospitality Management në University of Portsmouth**. Procesi i aplikimit për studime në UK mund të duket i ndërlikuar, por falë mbështetjes së Englanders gjithçka u bë shumë më e thjeshtë dhe e qartë. Nga përzgjedhja e universitetit dhe programit të duhur, deri te aplikimi dhe dokumentacioni, mora guidë profesionale në çdo hap.

Jam shumë i kënaqur me eksperiencën dhe e rekomandoj për këdo që dëshiron të studiojë në UK. Faleminderit Englanders për gjithë mbështetjen!



Fakultetet / Departamentet

- Biznes dhe Drejtësi
- Industri Kreative dhe Kulturore
- Shkenca Humane dhe Shoqërore
- Shkenca dhe Shëndeti
- Teknologji

Arritjet

- Ndër 30 universitetet kryesore në MB për vlerësimin e studentëve.
- **#12 në UK** për mundësi praktike dhe internship-e sipas vlerësimeve të RateMyPlacement 2025/26
- Vlerësuar me **5 yje** për mësimdhënie, punësim dhe përfshirje studentore.

Kampuset

- **Kampusi kryesor:** University Quarter & Northern Quarter, Portsmouth
- **London Campus** (Waltham Forest) - Ofron një model mësimi me block teaching dhe orare të përcaktuara me teste të integruara, kampusi synon të mbështesë rritjen ekonomike lokale dhe krijimin e vendeve të punës.



6. Cambridge School of Visual & Performing Arts (CSVPA)

Cambridge School of Visual & Performing Arts (CSVPA) është një shkollë kreative dhe e performancës me kampuse në Cambridge dhe Londër, e njohur për programe në Art & Design, Fashion, Music dhe Performing Arts. Me bashkëpunime me institucione prestigjioze si Royal Academy of Dramatic Art, London University of the Arts dhe Kingston University, CSVPA ofron Diploma, Foundation, Bachelor dhe Master.

CSVPA përgatit studentët për të hyrë në institucionet më të mira të arsimit të lartë në Britani dhe në botë.

- CSVPA ofron programe në Art & Design, Fashion, Music dhe Performing Arts, të orientuara drejt karrierës kreative.
- Klasa të vogla (deri 15 studentë) me qasje individuale për zhvillimin e potencialit artistik.
- Programe të vlefshme nga University of the Arts London dhe bashkëpunime me institucione prestigjioze si RADA dhe Kingston University.
- Studio dhe ambiente profesionale me pajisje dhe materiale të përfshira për praktikë intensive.
- Fokus i fortë në ndërtimin e portofolit dhe përgatitjen për tregun e punës.
- Pjesëmarrje e garantuar në Graduate Fashion Week në Londër për studentët e modës.
- Mësimdhënie nga profesionistë të njohur të industrisë dhe workshop-e praktike.
- Komunitet ndërkombëtar dhe alumni të punësuar në marka globale ose krijues të markave individuale.

Shkova në CSVPA kur isha 17 vjeç.

Kisha mundësinë të praktikoj forma të ndryshme arti, gjë që më ndihmoi të vendos se çfarë dua të ndjek në studimet universitare dhe të kuptoj çfarë më pëlqen vërtet të bëj.

Në përgjithësi, CSVPA ishte një kolegji i mrekullueshëm që unë personalisht e kam dashur shumë.

Faleminderit Englanders për ndihmën dhe mbështetjen tuaj si me shkollën ashtu edhe me aplikimet për vizë.

Pa ju, asgjë nga këto nuk do të ishte e mundur.

Mejsi Kamberi

Program -Continued studies at Ravensbourne University London after completing a Foundation Diploma in Art and Design ne CSVPA.



CAMBRIDGE
SCHOOL OF
VISUAL &
PERFORMING
ARTS

Fakultetet / Departamentet

- Undergraduate: Art & Design, Graphic Design, Illustration, Fashion, Visual Communication
- Postgraduate: MA Art & Design, MA Fashion, MA Visual Communication
- Performing Arts: Music Performance, Drama & Performance, Musical Theatre
- Nivelet Foundation & Diploma përfshijne kurse në fushat kreative.

Arritjet

- Studentët e CSVPA kanë fituar shumë çmime në Graduate Fashion Week
- Alumni punojnë për marka globale si Vivienne Westwood dhe Esquire
- Alumni të famshen: Daisy Waterstone dhe Scott Walker

Kampuset

- Në qendër të Cambridge, përballë Round Church dhe më pak se 5 minuta në këmbë nga King's College.



7. BPP University, London

BPP University është një nga shkollat private lider në Mbretërinë e Bashkuar për Drejtësi, me mbi 30 vite përvojë. Me një komunitet ndërkombëtar studentësh, universiteti ofron network të fortë profesional.

BPP University Law School ndodhet në mënyrë strategjike në zemër të "legal London" në Holborn dhe në Southbank (Waterloo), pranë gjykatave, firmave ligjore dhe qendrave tregtare, duke krijuar mundësi reale praktike dhe punësimi

- Universitet i specializuar në arsim profesional në Drejtësi, Biznes, Kontabilitet, Financa, Shëndetësi dhe Psikologji, me mbi 100 programe studimi.
- Ofron trajnime për kualifikime të njohura ndërkombëtarisht në ACCA, AAT, CIMA, ICAEW, ATT dhe CIOT, me norma shumë të larta kalueshmërie.
- Gati 50 vite eksperiencë në trajnimin e profesionistëve të kontabilitetit dhe edukon mbi 36,000 studentë çdo vit
- Trajnon talente për të katër firmat Big 4 dhe bashkëpunon me 600+ punëdhënës ligjorë në Mbretërinë e Bashkuar.
- Programe të ndërtuara ngushtë me industrinë, të fokusuara në aftësi praktike dhe punësim të menjëhershëm pas diplomimit.
- Mundësi studimi online, online live ose në kampus, duke ofruar fleksibilitet maksimal për studentët.
- Kampuse në qendër të Londrës dhe komunitet ndërkombëtar me studentë nga 120+ vende, duke krijuar lidhje të forta profesionale globale.

Faleminderit EnglandersCR ! Znj. Mezani e jashtëzakonshme me asistencën e saj gjatë gjithë procesit, hap pas hapi deri në marrjen e vizës angleze. Jo vetëm profesioniste por edhe shumë pozitive e tepër mbështetëse. Do mbeteni gjatë në kujtesën time. Hugs

Margalina Cibukaj
Program - Accounting & Finance



Fakultetet / Departamentet

- Drejtësi
- Biznes
- Teknologji
- Shëndet dhe Infermieri

Arritjet

- Mban statusin **“Content partner per provimet ACCA”**.
- BPP ka fituar Çmimin AGCAS për Barazi, Diversitet dhe Përfshirje 2023 për Skemën e Mesimdhënies

Kampuset

- **Londër** – Holborn: Qendra tradicionale e “Legal London”, ideale për studime juridike
- **Londër** – South Bank / Waterloo: Kampus modern në një zonë dinamike profesionale të Londrës



8. University of East London (UEL)

The University of East London (UEL) është një universitet publik dinamik me kampuse në Stratford dhe Docklands, UEL kombinon edukimin akademik me lidhjet e forta me industrinë, duke përgatitur studentët në Biznes, Inxhinieri, Shëndetësi, Arte dhe Ligj.

Programet përfshijnë vitet përgatitore, mundësi praktikash dhe bursa, duke siguruar një fillim të fortë për karrierën dhe zhvillimin profesional.

- 83% të studentëve janë në punë ose studime brenda 6 muajsh pas diplomimit.
- Programet BA përfshijnë vit përgatitor (foundation year). Postgraduate përfshijnë: master, doktoratura profesionale dhe MPhil/PhD.
- Kurrikula e fokusuar në karrierë përfshin internships, praktika profesionale dhe projekte të lidhura me industrinë.
- Partneritete me kompani si Siemens, Amazon, Barclays, NHS dhe BBC për praktikë dhe mentoring.
- Departamentet në Arkitekturë, Psikologji, Menaxhim dhe Kompjuterik renditen ndër më të mirat në MB.
- Arkivi historik dhe koleksioni i librave të British Olympic Association, me dokumente që datojnë që nga 1906.
- Alumni të njohur si Sonam Kapoor, Marina Diamandis dhe Kemi Adeosun etj.
- 92% e kërkimeve vlerësohen si të shkëlqyera ose të njohura ndërkombëtarisht

Unë jam **Kleida Vajushi**. Kam ardhur në London në vitin 2023 për të studiuar **MSc në Psikologji në University of East London**. Agjencia Englanders më mbështeti me vizën e studentit dhe bëri ëndrrën time të realizohet.

Dua t'u falënderoj për komunikimin e shkëlqyer dhe shpjegimet që e bënë rrugëtimin tim më të lehtë!

Faleminderit edhe një herë – pa dyshim, agjencia më e mirë!



University of
East London

Fakultetet / Departamentet

- Arkitekturë, Llogaritje dhe Inxhinieri (ACE)
- Arte dhe Industri Kreative (ACI)
- Kujdesi i Fëmijëve dhe Shërbimi Social
- Shëndet, Sport dhe Bioshkencë (HSB)
- Royal Docks – Biznes dhe Drejtësi

Arritjet

- Universiteti i Vitit 2025 për Cilësinë e Mësimdhënies
- Universiteti me rritjen më të shpejtë në Angli për punësimin e të diplomuarve
- #2 në Londër dhe #4 në Angli për pozitivitetin e përgjithshëm të studentëve

Kampuset

- **Stratford Campus** – Zemra e Londrës Lindore, me network profesional, internships dhe mjedis multikulturor.
- **Royal Albert Dock Campus** – Afër Canary Wharf, me laboratorë modernë, hapësira kreative dhe lidhje direkte me industrinë.



9. Brunel University (University of London)

Brunel University London është një universitet publik kërkimor në Uxbridge, Londër Perëndimore, i njohur për fokusin e tij në teknologji, inovacion dhe sipërmarrje. Themeluar në 1966, Brunel ofron programe Bachelor, Master dhe profesionale të dizenuara për të rritur punësimin dhe për të siguruar përvojë praktike.

Me qendra kërkimore ndërdisiplinore, departamente aktive dhe partneritete të forta me industrinë e punës, universiteti përgatit një komunitet ndërkombëtar që përballon sfidat globale dhe zhvillon zgjidhje inovative.

- Lidhje me 1,500+ kompani, me mundësi internships, projekte praktike dhe network profesional.
- Programet Bachelor me vit/e praktikë opsionale për zhvillim profesional.
- Alumni të suksesshëm në kompani si Barclays, Centrica, JP Morgan, si dhe gjyqtarë, deputetë dhe sipërmarrës.
- Kurs anglisht në Language Centre për ata që nuk plotësojnë kërkesat gjuhësore.
- Infrastrukturë moderne: laboratorë, studio dramatike dhe performancash, studio vizuale/green room dhe qendra sportive.
- Jetë studentore aktive me klube, shoqëri, evente kulturore dhe sportive që mbështesin zhvillimin dhe ekspozimin personal ndaj networkut.

Përshendetje nga unë **Vilma**, studente në **Brunel University**.

Kam mbaruar studimet për **Accounting and Business Management** dhe dua të falenderoj pafundësisht agjentet e Englanders, e cila bëri të mundur ardhjen time këtu mbi të gjitha bashkë me bashkshorting që është një mbështetje shumë e madhe për mua.

Vilma Bahja

Program - MSc Accounting & Business Management



Brunel
University
London

Fakultetet / Departamentet

- Biznes, Arte dhe Shkenca Shoqërore
- Inxhinieri, Dizajn dhe Shkencat Fizike
- Shëndetesi, Mjekësi dhe Shkencat e Jetës

Arritjet

- Renditet në 25% e universiteteve më të mira në botë (QS).
- I pari në MB për perspektivën ndërkombëtare (THE).
- Më shumë se 95% e kurseve BA ofrojnë mundësi për praktikë profesionale.

Kampuset

- **Uxbridge Campus**, West London, transport publik Tube nëpërmjet Piccadilly station.



10.Coventry University

Coventry University, pjesë e grupit Coventry University Group <https://www.coventry.ac.uk/cul/> është institucion akademik publik inovativ, i njohur për fokusin e fortë në punësim dhe mësim praktik të spikatur në industrinë motorike.

Me programe në fusha si biznes, teknologji, inxhinieri dhe shëndetësi, universiteti bashkëpunon ngushtë me kompani ndërkombëtare dhe ofron praktikë, laboratorë modernë dhe mbështetje të fortë për karrierë.

- Mundësi fillimi në Shtator, Janar ose Maj, me strukturë të qartë studimi.
- Mësimdhënie e bazuar në projekte për përgatitje reale për tregun e punës.
- Coventry njihet si “Qyteti i Motorëve” i Mbretërisë së Bashkuar dhe universiteti është një qendër e fuqishme për dizajnin e makinave.
- Bashkëpunime me Unipart Manufacturing, HORIBA MIRA, FEV dhe kompani si Barclays, IBM, Deloitte dhe Siemens.
- Workshop-e, mentoring dhe programi Phoenix+ për zhvillim profesional.
- 38,000 studentë në MB, përfshirë 13,000+ ndërkombëtarë nga mbi 160 shtete.
- I vendosur në qendër të Coventry city, me ambiente bashkëkohore dhe mbi £350 milion investime në infrastrukturë gjatë 10 viteve të fundit.
- Nëse nuk plotësoni kriteret për një diplomë të plotë, mund të nisni me Vitin Foundation apo Pre master për të plotësuar kushtet e pranimit.

“ Ambjenti është fiks siç ma keni e përshkruar ju, jam shumë i kënaqur me shkollën dhe vendin ku ndodhet shkolla.

Falë mbështetjes suaj unë sot studioj në Coventry University për Engineering. Në çdo hap të procedurës së aplikimit jam ndjerë i sigurtë, deri në marrjen e vizës, pasi ju e keni e bërë atë më të lehtë dhe më të shpejtë.

Klaudio Cubaj

Program - BsC (Hons) Construction Management



Fakultetet / Departamentet

- Biznes dhe Drejtësi
- Inxhinieri, Mjedis dhe Informatikë
- Shëndetësi dhe Shkenca Humane
- Arte

Arritjet

- Vlerësim Gold në kuadrin britanik të cilësisë së mësimdhënies (Teaching Excellence Framework – TEF)
- 5 Yje në vlerësimin e përgjithshëm, me nota maksimale për punësueshmëri
- Rreth 95% e të diplomuarve janë në punë ose vazhdojnë studimet brenda 6 muajve pas diplomimit.

Kampuset

- Qyteti Coventry kampus
- London: Dagenham dhe Greenwich



11. University of Manchester

The University of Manchester është një nga universitetet më të mëdha dhe më prestigjioze në Mbretërinë e Bashkuar, pjesë e Russell Group.

I themeluar mbi 200 vite më parë, është një qendër e ekselencës në mësim dhe kërkim shkencor, me 26 fitues të Çmimit Nobel dhe ndikim global në inovacion, shkencë dhe shoqëri.

Greater Manchester ka një popullsi prej 2.8 milion banorë dhe është zona metropolitane nr. 2 më e madhe në Britani me mundësi jetese dhe ekspozimi karriere të krahasueshme me Londrën.

- Bachelor dhe master me mundësi 1-year foundation për studentët ndërkombëtarë dhe blended learning kombinon mësimin online dhe në auditor.
- Universiteti zotëron dhe operon asete të mëdha kulturore, përfshirë Muzeun e Mançesterit, Galerinë e Artit Whitworth dhe Observatorin e Bankës Jodrell (pjesë e Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s).
- Lider botëror që renditet në dhjetë vendet e para në nivel global për ndikim social dhe mjedisor çdo vit që nga lançimi i <https://www.timeshighereducation.com/impactrankings>.
- Laboratorë, biblioteka dhe qendra kërkimore me teknologji të fundit.
- Mundësi praktike dhe pune pas diplomimit me kompani si Google, Rolls-Royce, AstraZeneca, Deloitte, PwC, KPMG, Barclays, EY, IBM dhe Unilever.
- Studentë nga mbi 160 vende, duke krijuar një mjedis kulturor global.
- Universiteti është shtëpia e The Mancunian, gazetës studentore me tirazhin më të madh në Mbretërinë e Bashkuar, dhe Fuse FM, një stacion i famshëm radiofonik studentor.
- Akomodim i garantuar për studentët e rinj Bachelor në Fallowfield, Victoria Park ose City Campus.

Unë jam **Senad** dhe aktualisht studioj **Electrical Engineering** në **University of Manchester**. Englanders më dha mundësinë të fitoj bursën ESBA për shkollat e mesme. Pas përfundimit të 2 viteve A-Level, arrita të vazhdoj studimet në një nga universitetet më të mira për degën që kisha zgjedhur.

Do t'ju sugjeroja të gjithëve që momenti më i mirë për t'u futur në sistemin akademik britanik është që në shkollë të mesme, pasi kështu rritni shumë shanset për t'u pranuar në universitetet më të mira. Faleminderit për mbështetjen!

Senad Kalaci

Program - Electrical Engineering - Fitues i Bursës ESBA nga Englanders

MANCHESTER
1824

The University of Manchester

Fakultetet / Departamentet


- Shkencë dhe Inxhinieri
- Shkenca Humane
- Biologji, Mjekësi dhe Shëndet
- Financë
- Shkencat Sociale

Arritjet

- Një nga 10 universitetet më të mira në MB për punësueshmërinë e të diplomuarve
- 95% e kërkimeve të Universitetit të Manchesterit janë vlerësuar si udhëheqëse në nivel botëror ose të shkëlqyera në nivel ndërkombëtar
- 26 fitues të Çmimit Nobel midis stafit dhe studentëve të tij aktualë dhe të mëparshëm.

Kampuset

- **Kampusi Jugor** – Oxford Road Campus (Manchester)
- **Kampusi Verior** – Sackville Street Campus (Manchester)



12. University of Westminster

University of Westminster është një universitet historik në Londër me mbi 175 vjet eksperiencë.

Veçanërisht i njohur për Shkollën e Medias, Arteve dhe Dizajnit, e cila është vlerësuar ndër më të mirat në nivel global, dhe programet e saj të Komunikimit dhe Studimeve të Medias, të renditura lart, me fokus të veçantë në punësim dhe aftësi profesionale. Kampuset e qendrës së Londrës ofrojnë akses të drejtpërdrejtë në network, kulturë dhe praktikë profesionale.

- Shumë programe bachelor ofrojnë një "Sandwich Year" opsional, duke e zgjatur studimin në katër vite dhe duke përfshirë një vit praktike profesionale në industri.
- Unioni i Studentëve të University of Westminster (UWSU) mbikëqyr dhjetëra shoqata dhe klube të drejtuara nga studentët, nga salsa deri të fotografia.
- Universiteti operon në katër kampuse, prej të cilave tre ndodhen në qendër të Londrës (Regent Street, Marylebone dhe Cavendish), duke i vendosur studentët vetëm pak hapa larg pikave të njohura si Baker Street dhe Oxford Street.
- Bachelor dhe master në media, biznes, dizajn, arkitekturë dhe teknologji, me internship-e dhe projekte praktike të integruara.
- Është një nga institucionet e pakta në Mbretërinë e Bashkuar që ofron bursa të plota për disa studentë pasuniversitarë, duke mbështetur financiarisht mbi 700 studentë çdo vit.
- Zona 29: Duke u lançuar në vitin 2026, kjo qendër e re në 29 Marylebone Road është projektuar të jetë qendra më gjithëpërfshirëse e Mbretërisë së Bashkuar për punësim dhe sipërmarrje. <https://www.westminster.ac.uk/study/student-life/why-westminster>
- Partneritete me industri si BBC, Warner Music, Universal Studios, Google, PwC dhe Deloitte, me mundësi internship-e dhe projekte profesionale.
- Student Union organizon klube sportive, shoqëri dhe evente sociale, duke krijuar një komunitet të pasur dhe aktiv.
- Është shtëpia e një prej pak suitave Bloomberg për Tregjet Financiare në Mbretërinë e Bashkuar, duke u ofruar studentëve akses në të dhëna financiare të nivelit profesional.

Unë jam **Sefrid** dhe sapo mbarova studimet për **Computer Science** në **University of Westminster**. Rrugëtimi im në Mbretërinë e Bashkuar filloi që në shkollë të mesme, falë bursës ESBA. Gjatë kësaj periudhe përfundova studimet A-Level, të cilat më përgatitën shumë mirë për hapin e radhës akademik.

Kjo eksperiencë më dha mundësinë të fitoj edhe bursë për studimet Bachelor. Jam shumë mirënjohës Englanders për këtë mundësi dhe për mbështetjen gjatë gjithë këtij rrugëtimi!

Sefrid Kapllani

Program - BSc Computer Science - Fitues i Bursës ESBA nga Englanders

UNIVERSITY OF
WESTMINSTER 卍

Fakultetet / Departamentet

- Shkencë dhe Teknologji
- Shkenca Sociale dhe Humane
- Shkolla e Biznesit Westminster
- Arkitekturë dhe Mjedis i Ndërtuar
- Media, Arte dhe Dizajn (Westminster)

Arritjet

- E njohur për punësueshmëri të lartë të të diplomuarve në Londër
- Renditet i 29-ti në botë për perspektivë ndërkombëtare (Times Higher Education Young University Rankings 2018)
- Renditet i pari për mësimdhënie të bazuar në punë në University and Educator Awards 2023

Kampuset

- Regent Street Campus, Central London
- Marylebone Campus, Central London
- Harrow Campus, Greater London



13. Greenwich University

University of Greenwich është një universitet publik gjerësisht i njohur për pamjen e tij kinematografike dhe rëndësinë historike, duke u përshkruar shpesh si një nga ambientet universitare më të bukura në botë. Me vendodhje në Londër dhe Kent, siguron një mësimdhënie cilësore (TEF Gold) dhe lidhje të forta me industrinë.

Me mbi 200 programe dhe work placements të integruara, ai përgatit studentët për karrierë në biznes, inxhinieri, shëndetësi, shkencë, arte dhe industri kreative, në tre kampuse historike dhe dinamike.

- Mbi 200 programe undergraduate dhe postgraduate në biznes, inxhinieri, shëndetësi, shkencë humane dhe industri kreative, të ndërtuara me fokus në tregun e punës.
- Studentët e Infermierisë, dhe Shkencave Paramedike mund të marrin një mbështetje financiare prej të paktën 5,000 £ në vit. <https://www.gre.ac.uk/subjects>
- Workshop-e për CV, intervista dhe aftësi punësimi, të integruara gjatë studimeve
- Rreth 28,000 studentë, përfshirë studentë nga mbi 100 vende, duke krijuar një komunitet ndërkombëtar dhe gjithëpërfshirës.
- Kampus historik buzë lumit në Old Royal Naval College, pjesë e një UNESCO World Heritage Site.
- Instituti i Burimeve Natyrore (NRI) i universitetit është i famshëm për kërkime shkencore me ndikim global; puna e tij mbi bimën e kasavës është vlerësuar me Queen's Anniversary Prize për mbështetjen e sigurisë ushqimore në vendet në zhvillim.
- Bursa dhe grante të disponueshme, përfshirë International Scholarship Award.
- Studentët praktikojnë në mjedise reale, duke përfshirë një sallë për debate ligjore (mooting) për Juridikun, një njësi kujdesi kritik për studentët e shëndetësisë, dhe një qendër inovative simulimi.
- Përveç fillimit standard në shtator, shumë programe ofrojnë praninë edhe në janar dhe prill.

“Rrugëtimi im drejt studimeve në UK u bë shumë më i lehtë falë mbështetjes së Englanders. Ata më ndihmuan në çdo hap të procesit – nga përzgjedhja e programit të duhur deri te aplikimi dhe përgatitja e dokumentacionit.

Falë guidës së tyre profesionale, arrita të bëj një zgjedhje të sigurt për të ardhmen time dhe të filloj studimet në një universitet të njohur ndërkombëtarisht. Jam shumë mirënjohës për këtë eksperiencë dhe e rekomandoj Englanders për këdo që dëshiron të studiojë në UK!

Klodian Synaj

Program - BEng Civil Engineering (Extended)





Fakultetet / Departamentet

- Shkenca dhe Teknologji
- Edukim, Shëndetësi dhe Shkenca Njerëzore
- Ligj, Arte dhe Shkenca Sociale
- Biznes (Greenwich Business School)

Arritjet

- E njohur për punësueshmëri të lartë të të diplomuarve në Londër
- Renditet i pari për mësimdhënie të bazuar në punë në University and Educator Awards 2023
- Vlerësim Gold në Teaching Excellence Framework (TEF) 2023 për cilësinë e shkëlqyer të mësimdhënies

Kampuset

- Greenwich Campus – Greenwich, Londër
- Avery Hill Campus – Eltham, Londër jug-lindje
- Medway Campus – Chatham, Kent



14. Queen's University Belfast

Queen's University Belfast është një universitet publik kërkimor prestigjioz në Irlandën e Veriut, i themeluar në 1845.

Pjesë e Russell Group dhe i renditur ndër 200 universitetet më të mira në botë, Queen's ofron programe undergraduate dhe postgraduate me kërkim të nivelit botëror, mësim praktik dhe punësim të lartë pas diplomimit, në një qytet dinamik dhe mikpritës.

- Përfundoni pathway dhe diplomën në një plan të vetëm studimi, me një vizë të vetme përmes programit iCAS.
- iCAS (Integrated CAS) e thjeshton procesin e aplikimit dhe studimit jashtë vendit.
- Akomodimi ndodhet vtëm 10–20 minuta larg Queen's University Belfast International Study Centre.
- Programi ndihmon në kalimin nga shkolla e mesme në universitet, duke ndërtuar bazën akademike.
- Module të përshtatura për të përgatitur studentët për programin e zgjedhur të diplomës.
- Ofrohen lëndë në shkencë, inxhinieri, arkitekturë dhe biznes.
- Internship online gjatë verës me 3,500+ kompani në 70 vende, përmes partneritetit me Virtual Internships.

Një ndër ëndrrat e mia ka qënë gjithmonë të studioja në një vend jashtë Shqipërisë dhe unë sot studioj **Master Shkencor 'Planning and Development'** në Mbretërinë e Bashkuar, konkretisht tek Queens University në Belfast. Vlerësoj vërtet punën dhe vëmendjen e Englanders Cr. Faleminderit

Silvana Isufaj
Program - MSc Planning & Development



Fakultetet / Departamentet

- Inxhinieri dhe Shkenca Fizike
- Mjekësi, Shëndet dhe Shkenca të Jetës
- Informatikë, Inxhinieri
- Shkenca Sociale, Edukim dhe Punë Sociale
- Arte, Shkenca Humane
- Shkolla e Menaxhimit Queen's

Arritjet

- E para në MB për Bujqësi, Ushqim dhe Shkenca Veterinare, duke u dalluar për cilësinë akademike dhe kërkimin shkencor.
- E para në Russell Group për punësimin e të diplomuarve, me rezultate shumë të larta në employability pas studimeve.
- 117-ti në botë për cilësinë e kërkimit shkencor, sipas renditjeve ndërkombëtare të arsimit të lartë.

Kampuset

- Main Campus – në zemër të Belfast City Centre
- Elms BT9 Campus – në zonën BT9, Belfast
- Somerhill Campus – në Belfast jug-perëndim
- Belfast Education Campus – në Belfast veri-perëndim



15. University of Reading

Universitet publik kërkimor në Reading, me gati një shekull traditë akademike që i ka rrënjët në zgjerimin e kolegjeve të Universitetit të Oksfordit në shekullin e 19.

I njohur për inovacion, kërkim të avancuar dhe mësimdhënie të lidhur me zhvillimet më të fundit, universiteti ofron programe të shumëllojshme që variojnë nga shkencat, biznesi, artet deri tek shkencat humane.

- Pozicion qendror, vetëm 30 minuta nga Londra (Tube Paddington), 45 min nga aeroporti Heathrow dhe 90 minuta nga Gatwick.
- Mbi 50 qendra kërkimore, shumë prej tyre të njohura ndërkombëtarisht në bujqësi, shkenca biologjike, fizike dhe kultura evropiane.
- Shumë diploma janë të akredituara profesionalisht, duke siguruar që përmbajtja të përmbushë standardet e industrisë.
- Tre muze dhe koleksione speciale të aksesueshme për studim dhe kërkim.
- Reading Students' Union (RSU) organizon mbi 150 klube sportive dhe shoqata, si dhe një klub të madh nate, 3sixty.
- Akreditim "Kurorë e Trefishtë": 1% e shkollave më të mira të biznesit në botë. Institucionet akredituese: AMBA (Britani), EQUIS (Europë) dhe AACSB (SHBA)
- Kampuse të gjelbra, të vlerësuara me çmime, që kombinojnë ambiente moderne me një komunitet gjithëpërfshirës.

Unë jam **Melisa Brojaj** dhe kam studiuar **Foundation Year** për Biznes në **University of Reading**.

Përvoja ime me Englanders ka qenë shumë pozitive dhe vendimtare për rrugëtimin tim akademik. Që nga momenti i parë, mora mbështetje të plotë në çdo hap të procesit. E rekomandoj Englanders për këdo që dëshiron një guidë të sigurt dhe të besueshme drejt studimeve në UK!



University of Reading

Fakultetet / Departamentet

- Biznesi-Henley
- Bujqësi, Politika dhe Zhvillimi
- Shkencat Biologjike
- Kimi, Ushqimi dhe Farmacia
- Drejtësia
- Psikologjia dhe Shkencat e Gjuhës Klinike
- Arte dhe Dizajn i Komunikimit
- Shkencat Matematikore, Fizike dhe Kompjuterike

Arritjet

- Lider botëror në shkencën e klimës, fitues i Queen's Anniversary Prize dhe THE Award për kontribut të jashtëzakonshëm në leadership mjedisor.
- Renditet në vendin **e 1-rë për biznes dhe menaxhim në UK** The Daily Mail University Guide 2025.
- Shërbime të vlerësuara për zhvillim karriere dhe mundësi praktike profesionale.

Kampuset

- Whiteknights Campus
- London Road Campus
- Greenlands Campus, Henley-upon-Thames



16. City St George's (University of London)

Lindi nga 'St George's Hospital Medical School', institucion publik dhe shkollë mjekësore prestigjioze në Jug të Londrës. Me mbi 130 vite histori, universiteti sot edukon mbi 27,000 studentë, duke kombinuar ekspertizën lider në mjekësi dhe shëndetësi me fusha si biznesi, ligji, shkencat dhe teknologjia për ndikim shoqëror të prekshëm.

- Programe të specializuara në mjekësi dhe shkenca shëndetësore, të ndërtuara mbi trashëgiminë e St George's dhe lidhjet e forta me National Health Service.
- I vetmi universitet në Mbretërinë e Bashkuar me një kampus të vecantë spitalor (St George's University Hospitals NHS Foundation Trust), studentët shkojnë në këmbë nga leksionet në repartet klinike.
- Jeta studentore përcaktohet nga një përvojë "më e mira e të dy botëve": komunitet i ngushtë dhe i specializuar brenda departamentit perkates kombinuar me stilin energjik të jetës së Londrës qendrore dhe jugore.
- Zhvillim i fortë karriere përmes përvojës praktike dhe trajnimeve të lidhura me industrinë.
- Bursa dhe grante me bazë merite dhe nevoje financiare për studentë ndërkombëtarë.
- Shkolla e Shkencës dhe Teknologjisë njihet në 10 më të mirat në Mbretërinë e Bashkuar për Inteligjencën Artificiale (Udhëzuesi Universitar Daily Mail 2026).
- Komuniteti ndërkombëtar studentor nga mbi 170 vende siguron mjedis multikulturor.

“Përshëndetje, unë jam një studente në Universitetin e **St George's Medical School** në Londër për degën **Biomedical Sciences**.

Dua të informoj studentët shqiptarë, në qoftë se keni mbaruar një gjimnaz në Shqipëri shanci për të studiuar mjekësi në Angli është pothuajse zero.

E konsideroj veten me fat të kem fituar bursën **Englanders** e cila më ka ndihmuar të vazhdoj **A-Levels** të avancuar, gjë që me dha shancin për të siguruar vendin tim për të studiuar mjekësinë.

Kejsi Balla

Programi - Bachelor në Biomedical Sciences (BA), Fituese e Bursës ESBA nga Englanders





Fakultetet / Departamentet

- Mjekësi
- Shkencat Biomedikale dhe Klinike
- Shëndeti dhe Shkencat Psikologjike
- Komunikimi dhe Kreativiteti
- Politikat Publike dhe Çështjet Globale

Arritjet

- Renditet universiteti i 38-të në Mbretërinë e Bashkuar (Complete University Guide 2025)
- Renditet i 4-ti në Londër dhe i 13-ti në Mbretërinë e Bashkuar (*People and Planet University League*)

Kampuset

- Tooting Campus – Tooting, Londër
- Clerkenwell & Moorgate Campuses – Qendra e Londrës



17. University of Sunderland (Londër dhe Sunderland)

Universitet publik kërkimor në verilindje të Anglisë dhe kampus alternativ në Londër, UoS renditet ndër **Top 30 universitetet më të mira në Mbretërinë e Bashkuar** sipas Guardian University Guide 2026. Ai njihet gjerësisht për fokus në punësueshmëri, duke ofruar programe të orientuara drejt karrierës për rreth 28,800 studentë në katër kampuse kryesore dhe përmes partneriteteve globale.

Përveç ekselencës akademike në Biznes, Media dhe Inxhinieri, Sunderland ofron një avantazh të madh për studentët ndërkombëtarë, pasi renditet vazhdimisht si një nga qytetet me koston më të ulët dhe më të përbalueshme të jetesës në të gjithë Britaninë. Universiteti është një lider në fushën e shëndetësisë me një shkollë mjekësie moderne dhe laboratorë simulimi të teknologjisë së fundit.

- Programe të akredituara nga liderë të industrisë si **CMI** dhe **IMechE**, duke siguruar që studentët janë gati për tregun e punës.
- Qendër kryesore për studimet në Infermieri dhe Shkenca Shëndetësore.
- Qyteti i Sunderland ka kosto jetese dhe qira shumë më të ulëta se mesatarja Britanike.
- Norma e pranimit vlerësohet midis 55% dhe 60%.
- Diploma UoS konsiderohet një "pasaportë" për punësim. Shumë programe, veçanërisht në Biznes, Media dhe Inxhinieri, përfshijnë module të punës praktike dhe projekte reale me partnerë si Nissan, Microsoft dhe NHS.
- Living Labs unike, që janë ambiente që imitojnë ambjentë spitalore, ku studentët e shëndetësisë ushtrohen në situata reale me pajisje apo ambulanca të pajisura plotësisht.
- Producenti i famshëm i filmave, Lord David Puttnam (*fitues i Oscar për Chariots of Fire*), punon drejtpërdrejt me studentët në David Puttnam Media Centre, një nga qendrat më të mira mediatike në vend.
- Universiteti i parë në Mbretërinë e Bashkuar që prezantoi kurset "sandwich" - studimet akademike të ndërthurura me një vit praktikë pune të paguar në industrite përkatëse.
- Shkolla e Farmacisë festoi 100-vjetorin në 2021 dhe mbetet nga më të vjetrat dhe më të respektuarat në të gjithë Britaninë.
- Për të lehtësuar jetën e studentëve, universiteti ofron një shërbim autobusi falas (Campus Bus) që lidh kampuset, konviktet dhe qendrën e qytetit çdo pak minuta.



Fakultetet / Departamentet

- Biznes, drejtësi dhe turizëm
- Arte dhe industri kreative
- Teknologji
- Edukim dhe shoqëri
- Shkenca shëndetësore dhe mirëqenie

Arritjet

- **#1 në Verilindje për cilësinë e mësimdhënies** nga The Times and Sunday Times Good University Guide 2026.
- Në top 10 universitetet evropiane për diversitetin e studentëve ndërkombëtarë në QS World University Rankings: Europe 2026.
- Renditur në top 10 në Mbretërinë e Bashkuar për shërbimet e mbështetjes së studentëve nga Daily Mail University Guide 2026.

Kampuset

- City Campus – Sunderland City Centre
- Sir Tom Cowie Campus at St Peter's – Sunderland (buzë lumit Wear)
- University of Sunderland in London – Canary Wharf, Londër
- University of Sunderland in Hong Kong – Wan Chai, Hong Kong

Rreth Englanders

KONSULENCI PËR STUDIME
JASHTË VENDIT

E themeluar në vitin 2014, Englanders CR është një organizatë jofitimprurëse e përkushtuar për të fuqizuar të rinjtë dhe profesionistët shqiptarë përmes mundësive ndërkombëtare në arsim dhe karrierë.

Qëllimi ynë është të ndihmojmë kandidatët të arrijnë standardet më të larta akademike dhe profesionale përmes trajnimit dhe këshillimit, duke u ofruar njëkohësisht mundësi për arsimim, praktika pune, punësim dhe shkëmbime kulturore jashtë vendit.

Faleminderit që po konsideroni një bashkëpunim me Englanders. Koha juaj është shumë e vlefshme dhe mundësitë e tregut të shumta. Ne urojmë t'a meritojmë plotësisht kohën që na dedikoni.

Filozofia jonë është: qoftë organizatat, qoftë individët, do të jenë të suksesshëm nëse nuk ndalojnë asnjëherë së mësuari, pra evoluojnë në vazhdimësi.

Ne mendojmë që çdo individ është i ndryshëm. Për pasojë dhe zgjidhja do të jetë e veçantë dhe e përshtatur me aspiratat personale. Gjithashtu mirëkuptojmë që faktor në vendimmarrje do të jetë një listë e gjatë konsideratash si:

- eksperiencia,
- standardi akademik i deritanishëm,
- niveli gjuhësor,
- lokacioni,
- rankimi,
- jeta studentore,
- programi akademik i kërkuar dhe synimet e punësimit.

Në bashkëpunim me institucionet akademike partnere përpiqemi të gjejmë zgjidhjen më të përshtatshme dhe të personalizuar për kushtet tuaja.

Ekipi ynë është gati t'ju ndihmojë. Na kontaktoni sot!



Adresa:

Rruga e Barrikadave Ish Kinema 17-Nentori Kati 2 - sipër marketit, Tirana, 1001

+355 69 862 4173

studime@englanderscr.al

www.englanderscr.al



Adresa